



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 3850/2 prot.

Pogradec, më 21, 10, 2025

Lënda:

Dërgohet materiali për shqyrtim e miratim.

Znj. Manjola KAMOLLI
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar Zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po Ju dërgojmë projekt vendimin, dokumentacionim justifikues dhe relacionin shoqërues, për: *“Miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistikë dhe sportive”*.

Me respekt,

K R Y E T A R I
Ilir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit + rregullorja: 5 (Pesë).

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 3 (Tre).

Vendimi i Asamblese së Përgjithshme: 2 (Dy).

Vendim i Këshillit të Administrimit: 2 (Dy).

Vendimi i Këshillit Artistiko – Kulturor + rregullorja: 4 (Katër).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më _____, 2025

PROJEKT – VENDIM

NR. _____, DATË _____, 2025

MBI

**RISHQYRTIMIN E VENDIMIT NR. 86, DATË 25.09.2025, “PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË FINANCIMIT TË PROJEKTEVE
KULTURORE, ARTISTIKË DHE SPORTIVË”, I KTHYER ME SHKRESËN
E PREFEKTIT TË QARKUT KORÇË NR. 900/1 PROT, DATË 08.10.2025,
ME LËNDË, “MBI BAZUESHMËRINË LIGJORE TË AKTEVE TË
KËSHILLIT”.**

Në mbështetje të; nenit 113 të Ligjit Nr. 8417, datë 22.11.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; shkronjës “k” të nenit 54 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Ligjit Nr.8480, datë 27.5.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”; Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar; Ligjit Nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; Ligji Nr. 79/2017 “Për sportin”; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.540, datë 21.12.1992, “Për krijimin e këshillave të kulturës dhe shpërblimin e tyre”, i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.121, datë 25.2.2005, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr.540, datë 21.12.1992 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e këshillave të kulturës dhe shpërblimin e tyre”, si dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec Nr. 109, datë 02.12.2021, “Për themelimin e shoqërisë "Qendra Multifunksionale Pogradec sh.a" dhe miratimin e aktit të themelimit", Vendimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec Nr.110, datë 02.12.2021, “Për miratimin e statutit të shoqërisë "Qendra Multifunksionale Pogradec sh.a", të konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën Nr. 1196/1 prot, datë 14.12.2021, me propozim të shoqërisë Qendra Multifunksionale Pogradec Sh.a dhe Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme, Këshilli i Bashkisë, pasi vlerësoi se vendimi i kthyer cenon interesat e bashkësisë, pasi subjektë të rregullores persona juridike dhe fizike,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren e financimit të projekteve kulturorë, artistikë dhe sportive, sipas tekstit bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Të ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Administrata e Bashkisë Pogradec, Këshilli Artistiko – Kulturor, dhe Administrata e Shoqërisë, Qendra Multifunksionale Pogradec Sh.a.
3. Vendimi të hyjë në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.
4. U shpall sot më datë ____ . ____ .2025.



**KRYETAR
MANJOLA KAMOLLI**



QENDRA MULTIFUNKSIONALE
POGRADEC Sh.a

**QENDRA MULTIFUNKSIONALE POGRADEC SHA
ADMINISTRATORI**



Nr. ____ Prot.

Pogradec, më ____ .2025

RELACION

MBI

**RISHQYRTIMIN E VENDIMIT NR. 86, DATË 25.09.2025, "PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË FINANCIMIT TË PROJEKTEVE
KULTURORE, ARTISTIKË DHE SPORTIVË", I KTHYER ME
SHKRESËN E PREFEKTIT TË QARKUT KORÇË NR. 900/1 PROT, DATË
08.10.2025, ME LËNDË, "MBI BAZUESHMËRINË LIGJORE TË AKTEVE
TË KËSHILLIT".**

E NDERUAR KRYETAR I KËSHILLIT !

TË NDERUAR KËSHILLTARË !

Këshilli i Bashkisë Pogradec me Vendimin Nr. 86, datë 25.09.2025, vendosi të miratojë, Rregulloren e Financimit të Projekteve Kulturore, Artistikë dhe Sportivë.

Vendimi i sipërcituar nuk është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë, dhe në shkresa Nr. 900/1 Prot, datë 08.10.2025, me lëndë, "Mbi bazueshmërinë ligjore të akteve të këshillit", ka relatuar se:

- *Ne rregullore evidentohen nje sere mangesish dhe pasaktesisht ne aspektin formal ashtu edhe ne permbajtje.*
- *Analiza e rregullores tregon mangesi te shumeta ne permbajtje, strukture dhe terminologji.*

Për sa më sipër, nga ana e Qendres Multifunkionale Pogradec Sh.a, u hartua nje draft rregullore e re, ne perputhje me kerkesat e shkreses së sipërcituar, sipas materialit bashkengjitur.

Si përfundim, pasi u ballafaquam me nenin 64, shkronja "i" e Ligjit Nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, ku parashikon se:

i) kthen për rishqyrtim jo më shumë se një herë në këshill vendime, kur vëren se ato cenojnë interesa të bashkësisë. Në rastin e kthimit të vendimit të këshillit nga kryetari i bashkisë, këshilli mund të miratojë të njëjtin vendim vetëm me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve,

, dhe pasi vleresojme se ky vendim cenon interesat e bashkësisë, pasi janë subjektë persona juridike dhe fizike, kërkojmë rishqyrtimin e Vendimit Nr. 86, datë 25.09.2025, "Për miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistikë dhe sportive", i kthyer me shkresën e Prefektit të Qarkut Korçë nr. 900/1 prot, datë 08.10.2025, me lëndë, "Mbi bazueshmërinë ligjore të akteve të këshillit", sipas teksit bashkëngjitur.

Duke shpresuar në miratimin e këtij materiali nga ana Juaj,

Ju Faleminderit,

PËRGATITI MATERIALIN:

Koneptuan:

Esmeralda SHKULAKU

Pranoi: DREJTOR

Klevis CANE

Miratoi: ADMINISTRATOR Dorian LATIFLLARI

Konfirmoi: KRYETAR

ILIR XHAKOLLI

RREGULLORE
PËR
FINANCIMIN E PROJEKTEVE KULTURORE, ARTISTIKE DHE
SPORTIVE



KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

NENI 1
QËLLIMI

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe mekanizmave për financimin e projekteve kulturore, artistike dhe sportive nga Bashkia Pogradec, nëpërmjet Qendrës Multifunksionale Pogradec Sha, në përputhje me statutin dhe aktin e themelimit, me synim mbështetjen dhe zhvillimin e jetës kulturore, artistike dhe sportive në territor të Bashkisë Pogradec.

NENI 2
OBJEKTI

2.1 Rregullorja, "Për financimin e projekteve kulturore, artistike dhe sportive", vendos rregullat normative, duke përcaktuar mënyrën e organizimit dhe funksionimit të skemës së financimit të projekteve kulturore, artistike dhe sportive, ndërmjet Qendres Multifunksionale Pogradec Sh.a dhe subjekteve përfituese, duke garantuar përdorimin me efikasitet, transparencë dhe llogaridhënie të fondeve publike të destinuara për këtë qëllim.

NENI 3
FUSHA E ZBATIMIT

3.1 Rregullorja zbatohet për të gjitha projektet që aplikojnë për mbështetje financiare në fushën e kulturës, artit dhe sportit.

3.2 Mbështetja e Bashkisë Pogradec, nëpërmejt Qendrës Multifunksionale Pogradec Sha, për projekte artistike – kulturore - sportive, të paraqitura nga persona fizikë e juridikë privat, vendas dhe të huaj si dhe shtetas shqiptarë të fushës së artit dhe kulturës, që kontribuojnë në promovimin e vlerave artistike, kulturore, sportin, për këto fusha jepen në formën:

- Me ambiente që administrohen nga Qendra Multifunksionale Pogradec Sha, ku zhvillohen aktivitete, si salla për shfaqje, ekspozita, panairë etj.
- Në mjete financiare, në formë mbështetje financimi.

3.3 Mbështetja financiare do të kryhet në përputhje me fondet e përcaktuara për këtë qëllim nga Bashkia Pogradec sipas buxhetit të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak dhe të alokuara tek buxheti i Qendrës Multifunksionale Pogradec Sha.

3.4 Bashkia Pogradec dhe Qendra Multifunksionale Pogradec Sh.a, do të ketë prioritet për mbështetjen e projekteve të cilat janë të mbështetura ose janë pjesë e programeve të ndryshme kulturore dhe me gjërë të Komunitetit European.

NENI 4 PARIMET BAZË

4.1 Në kuptim të kësaj rregullore do të quhet, Projekt kulturor – artistik - sportiv, çdo aktivitet që zhvillon vlera për artin, kulturën, turizmin, sportin etj.

4.2 Financimi i projekteve mbështetet mbi parimet:

- Transparencës
- Barazisë së mundësive
- Llogaridhënies
- Efikasitetit dhe efektivitetit
- Respektimit të trashëgimisë kulturore, sportive dhe kombëtare.

KREU II KRITERET E PËRGJITHSHME PËR FINANCIM

NENI 5 PËRFITUESIT

5.1 Subjektet e mbështetjes financiare janë:

1. Organizatat jofitimprurëse që ushtrojnë aktivitet në fushën e kulturës, artit dhe sportit.
2. Institucionet kulturore e sportive.
3. Shoqatat komunitare, klubet sportive dhe grupimet artistike.
4. Persona fizikë me status “artist i lirë” ose “sportist i lirë”, sipas legjislacionit në fuqi.

NENI 6 KRITERET PËR PROJEKTET

6.1 Projektet duhet të plotësojnë këto kushte:

1. Të kontribuojnë në zhvillimin e jetës kulturore, artistike ose sportive.
2. Të kenë ndikim të qartë komunitar.
3. Të paraqesin plan të qartë financiar dhe burime bashkë-financimi (kur aplikohet).
4. Të jenë në përputhje me strategjitë dhe prioritetet e Bashkisë/Institucionit.

KREU III PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE PËRZGJEDHJES

NENI 7 DOKUMENTAT QË DUHET TË DORËZOHEN NË MOMENTIN E PUBLIKIMIT TË PROJEKTIT

7.1 Çdo subjekt i përcaktuar në neni 5 i rregullorës, me qëllim përfitimin e mbështetjes financiare të plotë ose të pjesshme, paraprakisht duhet të dorëzojë dokumentat si më poshtë:

1. Kërkesë për përfitim financiar e protokolluar në Q.M.P. Sha.
2. Formularin e aplikimit.
3. Projekti artistik – kulturor, ndërtuar në bazë të të dhënave të përcaktuara në format e dorëzuara.
4. Ekstrakti i shoqërisë ose Vendimi i Gjykatës, Statuti i Shoqatës/Shoqërisë; Akti i themelimit; NIPT, fotokopje e statutit dhe e aktit të themelimit.
5. Vërtetim që Shoqëria/subjekti nuk është në proces likuidimi apo likuiduar.
6. Numri i llogarise bankare, IBAN.
7. Preventivi, total i detajuar me të gjitha zerat e tij, perkrah të jene shenuar donatoret perkates.
8. Preventivi pjesor, per zerat qe kerkohen nga Qendra Multifunksionale Pogradec Sha.
9. Deklarata mbi autorësinë e projektit, nese objekti artistik është individual.
10. Në rastin e bashkëpunimeve duhet të përcaktohet roli i pjesëmarrësve përkatës.
11. Fotokopje të kartës së identitetit ose pasaportës së aplikantit.
12. CV dhe/ose aktiviteti artistik.

Shënim: Në rast se kërkesa paraqitet nga një individ, duhet të paraqitet një biografi personale, CV dhe projekt të aktivitetit perkates.

NENI 8 PROCEDURA E GJYKIMIT PER FINANCIMIN E PROJEKTIT

8.1 Mbas dorëzimit dhe administrit të dokumentacionit të sipërcituar, Drejtoria, Qendra Kulturore “Lasgush Poradeci”, prane Qendres Multifunksionale Pogradec Sha, vlereson dhe gjykon perputhjen e projektit te paraqitur me programin e Bashksie Pogradec, dhe më pas kalon per shqyrtim/ miratim në Këshillin Artistiko – Kulturor.

NENI 9 VLERËSIMI I PROJEKTEVE

9.1 Pasi Këshilli Artistiko – Kulturor njihet me gjykimin e Drejtorisë, Qendra Kulturore “Lasgush Poradeci”, prane Qendres Multifunksionale Pogradec Sha, i vlerëson projektet mbi bazën e kritereve:

- Përputhshmëria me prioritetet strategjike.
- Cilësia dhe qëndrueshmëria e projektit.
- Ndikimi social dhe kulturor.
- Plan financiar dhe burimet e bashkë-financimit.

9.2 Keshilli Artistiko -- Kulturor, i miratuar nga Këshilli i Bashkisë Pogradec përbëhet nga 3 anëtarë, të cilët përfaqësojnë fusha të ndryshme.

9.3 Afati maksimal i shqyrtimit të projektit mbas dorëzimit në Q.M.P Sha është 15 ditë.

9.4 Në rast se kërkesa për mbështetje financiare refuzohet nga Këshilli Artistiko – Kulturor del me vendim refuzimi dhe më pas, administrata e shoqërisë duhet të njoftojë kërkuesin me njoftim përkatës.

9.5 Në rast se projekti miratohet, Keshilli Artistiko - Kulturor, zbardh vendim dhe autorizon administratorin të nënshkruajë kontratën perkatese me subjektin përfitues.

KREU IV KUSHTET E FINANCIMIT DHE MONITORIMIT

NENI 10 MARRËVESHJA E FINANCIMIT

10.1 Projektet e miratuara financohen mbi bazën e një **kontrate** ndërmjet Qendra Multifunktionale Pogradec Sha dhe përfituesit.

10.2 Kontrata përcakton: shumën, afatet, detyrimet, raportimet dhe penalitetet.

NENI 11 MONITORIMI DHE RAPORTIMI

11.1 Përfituesit në përfudnim të projektit janë të detyruar të paraqesin faturë të fiskalizuar për llogari të Q.M.P, për shumën që është mbështetur, si dhe dokumentat si më poshtë:

1. Situacionin (duhet të jetë i firmosur dhe i vulosur nga zbatuesi, të ketë date dhe të jetë i rakorduar me faturat për shpenzimet e kryera).
2. Raport financiar me të gjithë donatorët (situacioni faktik i preventivit total).
3. Relacion mbi zhvillimin e aktivitetit dhe impakti i tij në publik, dhe marrjen në dorëzim të projektit.
4. foto, si dhe materiale të tjera, dokumentare mbi zhvillimin e aktivitetit.

11.2 Qendra Multifunktionale Pogradec Sh.a, kryen monitorim në terren dhe verifikim të dokumentacionit financiar.

NENI 12 NDËRPRERJA E FINANCIMIT

12.1 Financimi ndërpritet në rast se:

- Përfituesi nuk respekton marrëveshjen.
- Fondet përdoren për qëllime të tjera.
- Raportet janë të rreme ose mungojnë

KREU V
DISPOZITA TË FUNDIT

NENI 13
ANKIMIMI

13.1 Aplikuesit që nuk kualifikohen kanë të drejtë të ankimojnë vendimin pranë Kryetarit të Bashkisë brenda 5 ditëve pune nga njoftimi i komunikuar.

NENI 14
HYRJA NË FUQI

14.1 Ngarkohen për zbatimin e rregullores, Administrata e Bashkisë Pogradec, Këshilli Artistiko – Kulturor, dhe Administrata e Shoqërisë, Qendra Multifunksionale Pogradec Sh.a.

KRYETAR
MANJOLA KAMOLLI